



**Universiteti i Elbasanit  
“Aleksandër Xhuvani”  
FAKULTETI EKONOMIK**

**PUNIM DIPLOME  
PËR PROGRAMIN E CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE  
MASTER I SHKENCAVE NË EKONOMIA DHE E DREJTA NË TREGJET  
NDËRKOMBËTARE**

**Përshtatja e Legjislacionit Shqipëtar me atë  
të BE.**

**Reforma në Drejtësi.**

**PUNOI**

**Eralda HOXHAJ**

**UDHËHEQËS**

**Prof. Asc. Dr. Arbër GJETA**

**Korrik 2023**

## ***ABSTRAKTI***

*Synimi i këtij punimi bachelor është të trajtojë temën në lidhje me etapat në të cilat kanë kaluar marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe BE, me proceset e anëtarësimit, lidhjen e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit dhe plotësimin e kriteve të nevojshme për integrim. Në vazhdimësi ky punim trajton procesin e ndryshimeve që kanë ndodhur në fushën e drejtësisë, si pasojë e Reformës në Drejtësi, si kusht kryesor për integrimin e Shqipërisë në familjen e madhe europiane.*

## ***DEKLARATA E ORIGJINALITETIT / AUTORËSISË***

*Ky Punim Diplome i nivelit bachelor është puna ime origjinale, e realizuar duke respektuar autorsinë e çdo burimi të informacioneve dhe rregullave për një punim të mirëfilltë shkencor, dhe nuk është dorëzuar, në tërsi apo pjesërisht, nga ndonjë student tjetër në këtë universitet.*

*Sipas njohurisë time, punimi nuk përmban asnjë material të botuar ose shkruar nga ndonjë person tjetër, përvecse siç deklarohet brenda tekstit. Gjithashtu, në shkrimin e punimit kam respektuar rregullat etike të punës shkencore dhe akademike të përcaktuara nga Universiteti Aleksandër Xhuvani.*

## **FALENDERIME**

*Punimi i temës së diplomës kërkon mund dhe përkushtim të madh i cili nuk mund të realizohej pa përkrahjen e njerëzve më të dashur, prandaj ju jam mirënjohëse dhe i falenderoj pafund të gjithë ata që më kanë mbështetur jo vetëm tani por për gjatë gjithë rrugëtimit tim studentor.*

*Fillimisht, dëshiroj të shpreh falënderimet e mia të përzemërta për stafin akademik të Fakultetit Ekonomik të Elbasanit, të cilët kontribuan me njohuritë e tyre gjatë gjithë kohës së studimit.*

*Një falënderim i veçantë i dedikohet mentorit tim, Prof.asoc.dr. Arbër GJETA që më orientoi me udhëzimet e tij të vlefshme, në mënyrë të vazhdueshme në realizimin dhe finalizimin e kësaj teme diplome.*

# ***PËRMBAJTJA***

## **ABSTRAKT**

## **DEKLARATA E ORIGJINALITETIT / AUTORËSISË**

## **FALENDERIME**

## **LISTA E SHURTIMEVE**

## **HYRJE**

## **KAPITULLI I : ZHVILLIMI I MARRËDHËNIEVE MES BE DHE SHQIPËRISË**

### **1.Pak histori mbi krijimin e BE**

#### **1.1. Procesi i integrimit të Shqipërisë në BE**

#### **1.2. Procesi i Stabilizim-Asocimit**

#### **1.3. Kriteret e Kopenhagenit**

#### **1.4. Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit**

#### **1.5. Objektivat e MSA me Shqipërinë**

#### **1.6. Plani Kombëtar për Integrimin Kombëtar**

## **KAPITULLI II : BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E DREJTËSISË DHE PUNËVE TË BRENDSHME**

### **2.Hyrje**

#### **2.1. Burimet e së Drejtës Europiane**

#### **2.2. Struktura institucionale e BE**

#### **2.3. Fushat e Bashkëpunimi mes BE dhe Shqipërisë**

#### **2.4. Raporti i KE mbi Progresin e Shqipërisë**

## **2.5. Asistenca Financiare e BE për Shqipërinë**

## **2.6. Procesi Screening**

# **KAPITULLI III : REFORMA NË DREJTËSI**

## **3.Reforma në Drejtësi**

### **3.1. Strategjia e Reformës në Drejtësi**

### **3.2. Institucionet e Drejtësisë**

### **3.3. Arritjet e Realizuara nga Reforma në Drejtësi dhe paketa e ligjeve në Reformën në Drejtësi**

### **3.4. Vetingu**

### **3.5. Lufta Kundër Korrupsionit**

### **3.6. Parandalimi i Korrupsionit**

### **3.6. Monitorimi i Reformës në Drejtësi**

## **KONKLUZIONET**

## **REKOMANDIMET**

## **REFERENCAT**

## ***LISTA E SHKURTIMEVE***

BE – Bashkimi European

EUROATOM- Komuniteti European i Energjisë Atomike

PPJS – Politika e Përbashkët e Jashtme e Sigurisë

GJED – Gjykata Europiane e Drejtësisë

PSA – Procesi i Stabilizim Asocimit

MSA – Marrëveshja e Stabilizim Asocimit

TBE – Traktati i Bashkimit European

TFBE – Trakati për Funksonimin e Bashkimit European

KE – Këshilli European

KSA – Komuniteti i Stabilizim Asocimit

COREPER – Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm të Shteteve Anëtare në BE

DPB – Drejtësia dhe Punët e Brendshme

KPH – Konferenca e Parë Ndërqeveritare

PHARE – Program Suporti për Sipërmarrjet e Vogla dhe të Mesme në Shqipëri

CARDS – Asistenca Komunitare për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim

IPA – Instrumenti i Para-Aderimit

KED – Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

GJK – Gjykata Kushtetuese

KLD – Këshilli i Lartë i Drejtësisë

KLGJ – Këshilli i Lartë Gjyqësor

KLP – Këshilli i Lartë i Prokurorisë

GJL – Gjykata e Lartë

PP – Prokurori i Përgjithshëm

BKH – Byroja Kombëtare e Hetimit

ILD – Inspektori i Lartë i Drejtësisë

SPAK – Struktura e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

ILDKPKI – Inspektoriati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit

VETINGU - Procesi i Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve

SHBA – Shtetet e Bashkuara të Amerikës

KPK – Komisioni i Pvarur i Kualifikimit

KPA – Kolegji i Posacëm i Apelit

ONM – Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit



## ***HYRJE***

E drejta e Bashkimit European është një e drejtë me një zhvillim të shpejtë e të vazhdueshëm. Procesi i integritit european e kaloi periudhën e pasigurisë, nëpërmjet hyrjes në fuqi të traktatit të Lisbonës, më 1 Dhjetor 2009, i cili rezulton pa dyshim një hap përpara në procesin e integritit. Në këtë punim do të paraqiten aspekte që nga ideja e krijimit të një Komuniteti European e deri te ndryshimet më të fundit të Traktatit të Lisbonës. Do të trajtohet historiku i integritit european që në fillimet e tij, deri te krijimi i Bashkimit European që njohim sot.

Për Bashkimin European, integrimi është një pjesë shumë e rëndësishme që ka të bëjë me përcaktimin e fushave të ndryshme si ekonomike, politike, monetare, të shtetësisë europiane dhe, së fundmi, me garantimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore. Në një këndvështrim tjetër do të tregohet dhe roli i rëndësishëm që politika dhe presionet e Shteteve anëtare kanë luajtur në etapat e ndërtimit të një Europe të suksesshme që shohim në ditët e sotme. Do të shihet gjithashtu sesi është bërë i mundur krijimi i një politike të jashtme dhe të sigurisë së përbashkët si dhe ndryshimet që kanë ndodhur në sistemin e drejtësisë së Shqipërisë, gjatë procesit të anëtarësimit në BE.

Zhvillimin e marrëdhënieve mes BE dhe Shqipërisë, si dhe zhvillimin në fushën e drejtësisë, kam vendosur ta paraqes në 4 kapituj. Përgjithësisht, kapitulli i 1 bazohet më së shumti në historikun e krijimit të BE dhe në etapat në të cilat ka kaluar Shqipëria për tu anëtarësuar në BE, si PSA, MSA, dhe objektivat që ka kjo e fundit me Shqipërinë.

Kapitulli i 2 paraqet burimet e së Drejtës Europiane, duke filluar nga e drejta e akteve parësore sic janë traktatet, dhe ajo e akteve dytësore si rregulloret, direktivat, vendimet, rekomandimet dhe opinionet. Gjithashtu një vëmendje e veçantë i kushtohet institucioneve të BE, analizës së detajuar të rolit, përbërjes dhe funksionit të tyre, bashkëpunimit në fushën e Punëve të Brendshme dhe ndihmesës financiare që BE i ka dhënë Shqipërisë, si programet Phare, Cards dhe Ipa.

Së fundmi, kapitulli i 3 trajton Reformën në Drejtësi, institucionet kryesore të reja që u krijuan dhe përmirësimi i institucioneve të mëparshme, dhe arritjet që solli kjo reformë e re. Gjithashtu në këtë kapitull përfshihet dhe procesi i Vetingut, lufta kundër korrupsionit, si dhe mënyrat për ta parandaluar atë.

Kam zgjedhur këtë temë për të mbrojtur diplomën, sepse është një temë që e hasim vazhdimisht, duke qënë se të gjithë shqipëtarët janë të interesuar për vazhdimësinë e negociatave dhe integritit të Shqipërisë në BE, dhe sfidat që po ndërmarim ne si shtet për ta bërë të mundur këtë gjë. Jam përpjekur që në këtë punim të paraqes evoluimin e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe BE, dhe ndryshimet që ka sjellë reforma në drejtësi, ndryshime këto të nevojshme, në mënyrë që të jemi kandidatë të denjë për anëtarësim.

# Kapitulli I : Zhvillimi i marrëdhënieve mes BE dhe Shqipërisë.

## *1. Pak histori mbi krijimin e BE.*

**Bashkimi European** është një bashkim politik dhe ekonomik i 27 shteteve anëtare të vendosura në Europë. BE ka zhvilluar një treg të brendshëm përmes një sistemi të standardizuar të ligjeve që zbatohen në të gjitha shtetet anëtare. Politikat e BE synojnë të sigurojnë lëvizjen e lirë të njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit në tregun e brendshëm, të miratojnë legjislacionin në drejtësi dhe në çështjet e brendshme, dhe të mbajnë politika të përbashkëta për tregti, bujqësi dhe zhvillimin rajonal.

Themelet për krijimin e BE u hodhën nga Ministri i Jashtëm Francez, Robert Shuman, në deklaratën e tij në 9 Maj 1950, në të cilën ai parashtrroi idenë për bashkimin e industrive evropiane të qymyrit dhe çelikut. Idetë e tij u bënë realitet me nënshkrimin e Traktatit të Parisit i cili themeloi Komunitetin European të Qymyrit dhe Çelikut më 18 Prill të vitit 1952.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm erdhi disa vite më vonë me Traktatin e Romës, në 25 Mars 1957, i cili themeloi Komunitetin Ekonomik European dhe Komunitetin European të Energjisë Atomike (EUROATOM). Këto komunitete krijuan një treg të përbashkët pa kufinj e barriera për mallrat e shteteve anëtare.

Krijimi i Bashkimit European u realizua me nënshkrimin e Traktatit të Mاستrihtit në 7 Shkurt 1992. Ky Traktat hasi një numër të madh pengesash gjatë procesit të ratifikimit të tij, të cilat bënë që Traktati të hynte në fuqi në 1 Nëntor 1993. Traktati përbën hapin e parë në rrugën drejt krijimit të një sistemi kushtetues European të përbashkët, në të cilin u përfshi sistemi me 3 shtylla, ku bënin pjesë :

- Komunitetet e Qymyr-Celikut, Ekonomik-European dhe Euroatom,
- Politika e Përbashkët e Jashtme e Sigurisë (PPJS),
- Bashkëpunimi në Çështjet e Brendshme dhe të Drejtësisë.

Bashkimi European mori një zhvillim të mëtejshëm me Traktatin e Amsterdami i cili u nënshkrua në 1 Tetor 1997 dhe hyri në fuqi në 1 Maj 1999, pas ratifikimit nga të gjitha

shtetet anëtare. Traktati i Amsterdami ka modifikuar përmbajtjen e Traktatit të Mاستrihtit ne 4 fusha kryesore :

1. Liria, Siguria dhe Drejtësia,
2. Qytetaria e Bashkimit European,
3. Politika e Jashtme dhe e Sigurisë,
4. Institucionet eBE.

Gjatë samitit të Nisës në 7-11 Dhjetor 2000, kryetarët e shteteve, si dhe ministrat e jashtëm të shteteve anëtare, pas shumë bisedimesh, ranë dakord për miratimin e një kushtetute për Bashkimin European. *Traktati i Nisës* përmban dispozita mbi ndarjen e pushteteve dhe procedurat vendimmarrëse të BE. Traktati u miratua në mënyrë perfundimtare nga qeveritë e shteteve anëtare në 26 Shkurt 2001, dhe hyri në fuqi në 1 Shkurt 2003, pas ratifikimit nga parlamentet e të gjitha shteteve anëtare.

Më pas në 2007 u miratua *Traktati i Lisbonës*, i cili është aktualisht baza ligjore e BE, dhe funksionon i ndarë në 2 akte, që janë :

1. *Traktati i Bashkimit European*,--përmban dispozita mbi qëllimet e BE, parimin e bashkëpunimit të sinqertë dhe respektimin e të drejtave të njeriut,
2. *Traktati për Funksionimin e Bashkimit European*,--është themeli i ligjit kushtetues të BE dhe përmban dispozita mbi ndërtimin institucional të BE, funksionet e institucioneve themelore dhe juridiksionin e GJED.

Traktati i Lisbonës solli ndryshime dhe risi të shumta, në ndryshim nga traktatet e tjera, si :

- Ndarje më të qartë kompetencash mes shteteve anëtare,
- E ardhmja e politikës së jashtme dhe të sigurisë,
- Rritje të rolit të parlamenteve kombëtare,
- Progres në fushën gjyqësore dhe në çështjet penale,
- Përfshirje të Kartës Themelore të të Drejtave të Njeriut në ligjin e BE.

### ***1.1 Procesi i integritit të Shqipërisë në BE.***

Marrëdhëniet diplomatike të Shqipërisë me BE zënë fill që në vitet '90, pas rënies së sistemit komunist. Kto marrëdhënie u zgjeruan më tepër në 11 Maj 1992, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Komunitetit Ekonomik European, e cila hyri në fuqi më 1 Dhjetor 1992. Marrëveshja synonte të vendoste rregulla për bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar mes palëve, dhe bazohej në Parimin e eliminimit të formave të ndryshme të diskriminimit. Ajo kërkonte harmonizimin e legjislacionit shqipëtar me ligjet komunitare, kryesisht në fushën ekonomike dhe tregtare, dhe parashikonte ngritjen e autoriteteve mbikqyrëse për zbatimin e saj, sic ishte Komiteti i Përbashkët i përbërë nga përfaqësues të të dyja palëve.

Gjate viteve 1996-1997, vendet e Ballkanit u hasën me krizën financiare dhe ekonomike, për shkak të krijimit të shteteve të reja dhe problematikave mes tyre. Kto zhvillime bënë që BE të hartonte një politikë përjasjeje rajonale për marrëdhëniet e saj me vendet e Ballkanit që ishin në krizë, ndër të cilat ishte dhe Shqipëria. Gjithashtu BE përcaktoi disa kushte politike dhe ekonomike, të rëndësishme për zbatuar nga kto vende, për të pasur një politikë transparente kryesisht në fushën e tregtisë, asistencës financiare, bashkëpunimit ekonomik, dhe të marrëdhënieve kontraktuale.

Vetëm në vitin 1999, BE miratoi një iniciativë të re për 5 vende te Ballkanit sic ishin Shqipëria, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina dhe Republika Federale Jugosllave, të quajtur Procesi i Stabilizim-Asocimit (PSA). Ky proces kishte për qëllim vendosjen e marrëdhënieve më të ngushta ndërmjet BE dhe këtyre vendeve, nëpërmjet Marrëveshjeve të Stabilizim-Asocimit (MSA), dhe dhënies së premtimit për tu anëtarësuar në BE.

Gjatë vitit 2000, KE vendosi se Shqipëria dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor ishin kandidatë potenciale për tu anëtarësuar, duke qënë se kishin arritur një zhvillim të qëndrueshëm politik dhe ekonomik. Gjithashtu u miratua një projekt-mandat për fillimin e hapjes së negociatave me Shqipërinë.

Hapja e negociatave zyrtarisht me Shqipërinë u arrit në vitin 2003, MSA u nënshkrua më 12 Qershor 2006 dhe hyri në fuqi më 1 Prill 2009, me qëllim përshtatjen e polikave institucionale, ligjore, ekonomike e sociale të Shqipërisë me BE.

Përgjatë viteve në vazhdim Shqipëria ka bërë përpjekje për të përafuar legjislacionin e saj me atë të BE, dhe janë zhvilluar takime të vazhdueshme për të parë ecurinë e Shqipërisë.

### ***1.2 Procesi i Stabilizim-Asocimit.***

PSA përbën një strategji për të rregulluar marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe BE, e cila ndikon në stabilitetin ekonomik dhe politik të vendit dhe ndihmon në anëtarësimin e tij në BE. Për të arritur këto qëllime PSA ka hartuar disa instrumenta, si Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit që vendos marrëdhëniet kontraktuale mes BE dhe vendeve candidate, si dhe projektet CARDS, PHARE dhe IPA, të cilat ndihmojnë secilin vend me ndihma financiare e teknike që të ndjekin ritmin e duhur drejt anëtarësimin në BE.

Vendet që marrin pjesë në PSA u nënshtrohen reformave transformuese me qëllim krijimin e shtetit të së drejtës dhe të një ekonomie tregu funksionale, nëpërmjet përafrimit të vazhdueshëm të legjislacionit komunitar me të drejtën e tyre të brendshme. PSA nuk është një proces dypalësh me çdo vend pasi është shumë e nevojshme edhe për bashkëpunim rajonal mes shteteve.

### ***1.3 Kriteret e Kopenhagenit.***

Anëtarësimi në BE kërkon përmbushjen e “Kritereve të Kopenhagenit” të cilat janë :

- **Kriteri Politik** - ka të bëjë me stabilitetin e institucioneve që lidhen me demokracinë, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut si dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve.
- **Kriteri Ekonomik** - lidhet me aftësinë për të ndërtuar një ekonomi tregu funksionale si dhe me aftësinë për të përballuar konkurrencën në tregun e BE.
- **Kriteri Legjislativ “acquis“** - ka të bëjë me platformën e të drejtave dhe detyrimeve që duhet të respektojë një shtet kandidat gjatë integritit evropian. Ky kriter përfshin traktatet, ligjet rregullat, parimet, vendimet e Gjykatës Europiane

dhe të gjitha aktet europiane në fusha të ndryshme si politika jashtme dhe e brendshme.

Kriter tjetër për anëtarësim përbën dhe aftësia e BE për të përfshirë anëtarë të rinj në rrethin e saj të gjërë. Komisioni Europian monitoron rregullisht përmbushjen e këtyre kriterëve, ndërsa procesi i anëtarësimit kalon nëpër disa etapa kyçe derisa vendi kandidat të konsiderohet plotësisht në gjendje për t'u bërë pjesë e BE. Negociatat e anëtarësimit qëndrojnë në themel të këtij procesi. Ato përfshijnë marrjen përsipër nga vendi kandidat të përafrimit të plotë të legjislacionit të BE, zbatimin e tij, si dhe krijimin e reformave ligjore, politike, ekonomike, e administrative si dhe reformave të tjera, të nevojshme për të përmbushur kriteret për anëtarësim.

Negociatat kalojnë nëpër tre etapa kryesore:

- Në shqyrtimin analitik të legjislacionit - Screening,
- Në hapjen dhe zhvillimin e tyre për çdo kapitull të “acquis”,
- Në mbylljen e negociatave për çdo kapitull dhe nënshkrimin e Traktatit të Aderimit.

#### ***1.4 Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit.***

MSA është një akt me fuqi detyruese për BE, shtetet anëtare dhe vendin e asociuar i cili hyn në fuqi sipas procedurave të parashikuara në traktatet e BE dhe kushtetutave të vendeve anëtare dhe të asociuara. MSA është dokumenti më i rëndësishëm kontraktual ligjor në procesin e integritit europian të Shqipërisë, duke sjellë dialog politik, bashkëpunim rajonal, treg të lirë dhe bashkëpunim në fushën e drejtësisë.

Ajo lidhet mbi bazën e nenit 217 të TFBE, që parashikon se bashkimi ka të drejtën të lidhë me shtetet e tjera marrëveshje që krijojnë asocim dhe përmbajnë të drejta dhe detyrime për palët, si dhe procedura specifike për anëtarësimin. Qëllimi kryesor i saj është krijimi i një tregu të lirë mes shteteve dhe bashkëpunimi në tregun e brendshëm. MSA janë të detyrueshme për tu zbatuar në momentin që botohen në fletoret zyrtare të vendeve të asociuara.

GJED ka sanksionuar se dispozitat e MSA kanë efekt të drejtpërdrejtë dhe mund të përdoren si bazë për paditë e ngritura përpara gjykatave të shteteve anëtare, nëse janë të

qarta, të sakta, dhe të pakushtëzuara. Sipas MSA, anëtarësimi do të realizohet në mënyrë progresive gjatë një periudhe 10 vjecare, e ndarë në dy faza të njëpasnjëshme, në mënyrë që realizohet sa më mirë procesi i përafrimit të legjislacionit me të drejtën europiane.

Në kuadër të MSA, ngrihet edhe struktura institucionale ku parashikohet krijimi i Këshilli i Stabilizim Asocimit, i cili është një forum i përbërë nga anëtarë të Këshillit të BE, që vihet në lëvizje nga palët për të diskutuar dhe mbikqyrur zbatimin e marrëveshjes.

Këshilli ka kompetenca vendimarrëse dhe vendimet e tij janë të detyrueshme për tu zbatuar nga secila palë. Gjatë zbatimit të detyrave të tij Këshilli ndihmohet nga Komiteti i Stabilizim Asocimit i përbërë nga anëtarë të Këshillit dhe Komisionit të BE, dhe nga anëtarë të shtetit të asociuar. Në fund parashikohet krijimi i Komitetit Parlamentar të Stabilizim Asocimit i cili është forumi i përbashkët i deputetëve të vendit të asociuar dhe Parlamentit Europian, për të diskutuar mbi zbatimin e marrëveshjes.

### ***1.5 Objektivat e MSA me Shqipërinë.***

Marrëveshjet e Stabilizim Asocimit lidhen mbi bazën e neneve të TFBE. Neni 1 i MSA me Shqipërinë përcakton :

1. Me anë të kësaj marrëveshjeje vendoset asociimi ndërmjet BE dhe shteteve të tij antëare nga njëra anë, dhe Shqipërisë nga ana tjetër.
2. Synimet e këtij asociimi janë :
  - Dhënia e kontributit për stabilitetin politik, ekonomik e institucional në Shqipëri, si dhe për stabilizimin e gjithë rajonit,
  - Të sigurojë një strukturë të përshtatshme për dialogun politik, duke lejuar zhvillimin e marrëdhënieve të ngushta politike ndërmjet Palëve,
  - Të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për zhvillimin e bashkëpunimit ekonomik dhe ndërkombëtar, gjithashtu dhe nëpërmjet përafrimit të legjislacionit të saj me atë të Bashkimit Europian,
  - Të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë për të përfunduar tranzicionin në një ekonomi tregu funksionale, të nxisë marrëdhënie ekonomike të harmonizuara dhe të zhvillojë gradualisht një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet BE dhe Shqipërisë,
  - Të nxisë bashkëpunimin rajonal në të gjitha fushat e trajtuara në këtë Marrëveshje.



## ***1.6. Plani Kombëtar për Integrimin Kombëtar***

Integrimi Evropian është objektivi gjeostrategjik dhe politik i Shqipërisë, që qëndron në thelb të politikës së brendshme dhe të jashtme të saj. Ky objektivi strategjik bazohet në vullnetin dhe mbështetjen e plotë të qytetarëve shqiptarë dhe sikurse përcaktuar në rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë të datave 11 prill 2019, 3 tetor 2019 dhe 18 qershor 2020, mbi përparimin e Shqipërisë në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe hapjen e negociatave të anëtarësimit.

Në bazë të prioriteteve të Programit qeverisës për periudhën 2021 – 2025, prioriteti i politikës së jashtme të Shqipërisë është avancimi më shpejt drejt anëtarësimit të plotë të Shqipërisë në BE.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian ka për qëllim të koordinojë këtë proces përafrimi duke synuar njëkohësisht plotësimin e detyrimeve në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe detyrimet që lindin si pjesë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Hartimi në kohë dhe me cilësi i Planit dhe monitorimi i tij janë parakusht për përshpejtimin e procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian. Cikli i hartimi dhe monitorimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian përbëhet nga këto procese:

1. Puna përgatitore;
2. Analiza e mangësive;
3. Planifikimi;
4. Hartimi dhe kontrolli i cilësisë;
5. Konsultimi dhe miratimi;
6. Monitorimi, raportimi, dhe vlerësimi.

Skematikisht, ky cikël programimi tregohet në figurën më poshtë.

**Figura: Lidhja mes proceseve të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian**



Veçanërisht të rëndësishme në këtë cikël planifikimi dhe monitorimi janë fazat e analizës së mangësive dhe planifikimit. Rezultati i këtyre proceseve mishërohet në dokumentin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, i cili tregon prioritetet e përafrimit të legjislacionit, ministritë përgjegjëse për hartimin e projektakteve shqiptare, shkallën e përafrimit, si dhe datën e miratimit. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme inicioi identifikimin e masave ligjore që do të përfshiheshin në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022 – 2024 që në fillim të muajit shtator 2021. Në këtë fazë, të gjitha ministritë dhe institucionet koordinuese u udhëzuan që të fillojnë analizën e mangësive dhe identifikimin e prioritetëve duke marrë në konsideratë përgjegjësitë në kuadër të strategjive ekzistuese ndërsektoriale/ sektoriale dhe hapësirën fiskale, sikurse përcaktuar gjatë fazës së parë të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 – 2024. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme inicioi njëkohësisht rishikimin e metodologjisë së hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, bazuar në eksperiencën e hartimit

të Planeve të mëparshme. Në këtë proces, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme u ndihmua edhe nga projekti “Mbështetje për integrimin evropian”, financuar nga Bashkimi Evropian.

Metodologjia e PKIE 2022 – 2024 paraqet këto ndryshime krahasuar me metodologjinë pararendëse:

- Bën një ndarje më të detajuar në proceseve të ndryshme në të cilat kalon hartimi, monitorimi dhe zbatimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian;
- Thekson dhe jep udhëzime më të plota në lidhje me procesin e analizës së mangësive ligjore dhe institucionale në këndvështrimin e negociatave të anëtarësimit;
- Jep udhëzime më të detajuara në lidhje me identifikimin e masave ligjore që do të planifikohen në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian;
- Jep udhëzime më të detajuara për kostimin e veçantë të çdo mase ligjore dhe zbatuese, në përputhje me Programin Buxhetor Afatmesëm;
- Përfshin dhe jep udhëzime mbi kryerjen e konsultimit me shoqërinë civile në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian.

Në vijim të miratimit të metodologjisë së Planit Kombëtar për Integrimin Evropian u zhvillua një cikël i plotë trajnimesh për drejtoritë/ njësitë e integritit në ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore, si dhe për stafin kyç të përfshirë në hartimin dhe zbatimin e këtij dokumenti. Edhe këto trajnime u zhvilluan në bashkëpunim me projektin “Mbështetje për integrimin evropian”, financuar nga Bashkimi Evropian. Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) 2022 – 2024 përfshin masa ligjore dhe zbatuese afatshkurtra dhe afatmesme që shtrihen deri në vitin 2024, duke synuar përafrimin gradual të legjislacionit shqiptar me *acquis* e Bashkimit Evropian.

PKIE-ja është e strukturuar në katër pjesë kryesore:

- Hyrja, në të cilën jepet një përshkrim i shkurtër i procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, strukturat e koordinimit në këtë proces dhe një përshkrim i vetë PKIE;
- Pjesa e dytë paraqet situatën aktuale dhe arritjet më të fundit në çështjet që kanë të bëjnë me Kriterin Politik. Kjo pjesë përfshin edhe arritjet në reformat kyçe të lidhura me shtetin e së drejtës, etj.;

- Pjesa e tretë përmbledh çështjet që kanë të bëjnë me Kriterin Ekonomik duke u fokusuar në situatën makroekonomike, stabilitetin financiar, etj.;
- Pjesa e katërt është pjesa planifikuese e PKIE-së, e ndarë në 33 kapituj që i përgjigjen 33 kapitujve negociues.

## **Kapitulli II : Bashkëpunimi në Fushën e Drejtësisë dhe Punët e Brendshme.**

### ***2.Hyrje.***

Drejtësia dhe Punët e Brendshme të BE është një nga fushat që ka ngritur pikpyetje dhe shqetësime mbi sovranitetin e shteteve anëtare dhe transferimin e pushtetit nga niveli kombëtar në atë të BE, si dhe për mbrojtjen e të drejtave themelore. Janë kto çështje që kanë sjellë nevojën për rritjen e kontrollit parlamentar nga Parlamenti Evropian dhe nga parlamentet kombëtare, si dhe rritjen e bashkëpunimit mes tyre.

Bashkëpunimi më i madh i parlamenteve kombëtare mund të ndikojë në formësimin e duhur të politikave dhe ligjeve të BE në fushën e drejtësisë, gjatë procesit të anëtarësimit. Krijimi i shtetit të së drejtës dhe lufta kundër korrupsionit, janë ndër pikat kryesore që BE ka vendosur për shtetet candidate. Adoptimi i legjislacionit të BE në fushën e Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme është një çështje e rëndësishme për të vendosur stabilitet dhe garanci në vend, në përputhje me vlerat dhe standartet e brendshme të BE.

Adoptimi i dispozitave në fushën e DPB nga shtetet candidate duhet të bëhet në mënyrë shumë të kontrolluar dhe të pandryshuara, duke ruajtur kontekstin e parashikuar nga BE. Bashkëpunimi mes parlamenteve ka qënë dhe vazhdon të jetë një sfidë për BE në fushën ndërkombëtare, në fushën e të drejtave themelore, dhe në standartet dhe vlerat mbi të cilat ajo bazohet.

### ***2.1 Burimet e së Drejtës Europiane.***

E Drejta Europiane bazohet mbi hiarkinë e normave, ku aktet juridike parësore kanë karakter kushtetues, dhe aktet juridike dytësore duhet të jenë në përputhje me ligjet parësore.

***A - E Drejta Parësore,*** përfshin :

- ***Traktati i Bashkimit European - (TBE)*** - përmban dispozita të përgjithshme mbi qëllimet kryesore të BE, parimin e bashkëpunimit të sinqertë, respektimin e të drejtave të njeriut, politikën e përbashkët të sigurisë, bashkëpunimin e avancuar, etj.

- **Traktati për funksionimin e Bashkimit Europian - (TFBE)** - është themeli i ligjit kushtetues në BE, pasi përmban dispozita të detajuara mbi ndërtimin institucional të BE, mbi juridiksionin e GJED, dhe mbi lëvizjen e lirë të mallrave dhe kapitaleve.
- **Traktati për krijimin e Komunitetit Ekonomik Europian - (EUROATOM)** - është baza ligjore për funksionimin e komunitetit EUROATOM, dhe përmban rregulla në lidhje me përdorimin e duhur të energjisë nukleare.

**B - Traktatet Ndërkombëtare**, janë marrëveshje që nënshkruhen mes BE dhe shteteve të tjera candidate për anëtarësim. Kto marrëveshje janë të detyrueshme për BE, shtetet anëtare në BE dhe për shtetet palë në marrëveshje, si MSA.

**C - E drejta Dytësore**, përfshin :

- **Rregulloret** – janë akte ligjore direkt të zbatueshme, të cilat bëhen pjesë e sistemit ligjor të shteteve anëtare pasi publikohen në Fletoren Zyrtare të BE. Qëllimi i tyre është unifikimi i ligjeve të shteteve anëtare, dhe krijimi i standarteve ligjore uniforme në të gjithë BE.
- **Direktivat** – shërbejnë si grup udhëzimesh lidhur me mënyrën e procedimit në një fushë të caktuar. Ato bëhen pjesë e kegjislacionit të brendshëm të shteteve anëtare pasi botohen në Fletoret Zyrtare të tyre, por sipas afateve të parashikuara në direktivë. Nëse ato nuk transpozohen në kohë ose të plota, shteteve u vendoset një gjobë financiare.
- **Vendimet** – janë akte individuale që i drejtohen nje shteti anëtar ose një individi të caktuar, dhe janë detyruese vetëm për palët që i drejtohen, si vendimet e KE.

**D - E Drejta e Butë – Soft Law**, përfshin :

- **Opinionet** – jepen për çështje të ndryshme gjyqësore, por nuk janë të detyrueshme për tu zbatuar, si opinionet e Avokatëve të Përgjithshëm.
- **Rekomandimet** – miratohen nga institucionet e BE, për të ndihmuar në interpretimin e normave të ndryshme ligjore.

**E - Jurisprudenca e GJED**, nuk është ligjërish burim i së drejtës, por luan rol kryesor në qartësimin e kuptimit të së drejtës europiane dhe në sigurimin e zbatimit të traktateve themelore të BE.

## ***2.2 Struktura institucionale e BE.***

- ***Parlamenti European***

Është organi që miraton ligjet së bashku me Këshillin e BE, dhe përfaqëson interesat e qytetarëve europianë. Anëtarët e tij zgjidhen në zgjedhjet e organizuara nga vendet anëtare, me mandat 5-vjecar dhe janë të ndarë në bazë të përkatësisë së tyre politike. Funkzioni i tij kryesor është të hartojë ligje dhe të miratojë buxhetin e propozuar nga Këshilli i BE.

- ***Këshilli European***

Është struktura më e rëndësishme politike që vendos për qëllimet, objektivat e përgjithshme dhe për prioritetet e BE. Këshilli përbëhet nga Kryetarër e Shteteve anëtare, Presidenti i Këshillit dhe Presidenti i Komisionit European. Ai mbledhet dy herë në 6 muaj, nuk ushtron kompetenca legjislativë por ka kompetenca lidhur me PPJS, si dhe me emërimin dhe funksionimin e institucioneve të BE. Gjithashtu Këshilli mer pjesë në procesin e anëtarësimit dhe të daljes së një vendi nga BE.

- ***Këshilli i Bashkimit European***

Është autoriteti më i lartë për marrjen e vendimeve bashkë me Parlamentin, dhe përfaqëson interesat e shteteve anëtare. Ai përbëhet nga ministrat e shteteve anëtare, të cilët mund të zëvendësohen nga anëtarët e COREPER. Këshilli mbledhet për çështje të politikës së jashtme, të ekonomisë, drejtësisë dhe punëve të brendshme. Gjithashtu ai ka të drejtë të lidhë marrëveshje të ndryshme me shtetet anëtare dhe shtetet kandidate, dhe koordinon çdo lloj aktiviteti të këtyre shteteve.

- ***Komisioni European***

Është një autoritet mbikombëtar që përfaqëson interesat e bashkimit si i tërë. Komisioni është i pavarur në qeverisjen e tij dhe nuk mund të marrë udhëzime nga shtetet anëtare. Anëtarët e tij zgjidhen nga shtetet anëtare dhe miratohen nga Parlamenti. Komisioni i paraqet propozime ligjore Parlamentit, zbaton ligjet dhe udhëzimet e miratuara nga ky i fundit, dhe përfaqëson BE në marrëdhëniet ndërkombëtare.

- ***Gjykata Europiane e Drejtësisë***

GJED ka për detyrë interpretimin dhe zbatimin e ligjeve dhe traktateve të bashkimit. Është e përbërë nga 27 Gjyqtarë dhe 9 Avokatë të Përgjithshëm, të cilët japin opinionin e tyre për çështje të ndryshme, por nuk janë të detyrueshme për tu zbatuar nga gjykata.

- ***Banka Qëndrore Europiane***

Është banka për monedhën e vetme europiane, **euro**. Detyra e saj është të ruajë fuqinë blerëse të euros dhe stabilitetin e cmimeve në eurozonë.

- ***Këshilli i Vëzhguesëve***

Kontrollon si është shpenzuar buxheti i BE dhe raporton një herë në vit te Parlamenti European.

### ***2.3 Fushat e Bashkëpunimit mes BE dhe Shqipërisë.***

Në marrëdhëniet mes BE dhe Shqipërisë, çështjet e drejtësisë janë prioritare për BE. Në kuadër të kësaj, kërkesat për përmirësimin e instrumentave të së drejtës kanë qënë të vazhdueshme. Ndër pikat më kryesore janë :

- rritja e transparencës në proceset gjyqësore,
- pavarësia e gjyqtarëve dhe mbrojtja e të drejtave të tyre,
- përmirësimi I statusit të administratës gjyqësore,
- rritja e bashkëpunimit ndërmjet organeve të drejtësisë,
- trajtimet e vazhdueshme të gjyqësorit,
- zbatimi i vendimeve gjyqësore, etj.

Me kalimin e viteve, Shqipëria po shkon drejt përmirësimit të organeve të drejtësisë, falë bashkëpunimit me strukturat europiane të drejtësisë. Në fushën e integritit të Shqipërisë me strukturat europiane, pika themelore qëndron në nevojën e bashkëpunimit në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme mes Shqipërisë dhe BE.

Në fushën e drejtësisë është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi ndërmjet administratave të drejtësisë të vendeve anëtare, përmes formave dhe kontakteve të vazhdueshme me legjislacionet përkatëse, dhe ndryshimet e herë pas hershme që mund të pësojnë ato. Palët



i kushtojnë rendësi të veçantë forcimit të sundimit të së drejtës, zbatimit të ligjeve, administrimit të drejtësisë, dhe në vecanti efikasitetit të saj.

Në fushën ekonomike eshë i domosdoshëm bashkëpunimi ndërmjet administradave doganore të vendeve anëtare, në lëvizjen e lirë të mallrave e kapitaleve dhe në lehtësimin e procedurave doganore të vendeve bashkëpunuese.

Në fushën e punëve të brendshme kërkohet bashkëpunimi ndërmjet forcave të policisë dhe ruajtjes së rendit të vendeve anëtare, për luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikëve. MSA ka ndikuar në një frymë të re në bashkëpunimin ndërveprues mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera europiane. Synimet kryesore të ktij asocimi janë :

- mbështetja e Shqipërisë në forcimin e demokracisë dhe sundimin e së drejtës,
- bashkëpunimi rajonal ne fushën e drejtësisë,
- nënshkrimi i konventave dhe marrëveshjeve pas hyrjes në fuqi të MSA,
- asistenca financiare për fusha të rëndësishme si drejtësia, ekonomia, etj.

#### ***2.4 Raporti i KE mbi Progresin e Shqipërisë.***

Raporti i fundit i BE i cili u publikua më 19 Dhjetor 2021 prezantoi arritjet e Shqipërisë duke bërë një përshkrim dhe analizë të hollësishme të të gjitha fushave që kanë pësuar zhvillim, ku një pjesë të rëndësishme e zuri Gjyqësori, Drejtësia, Liria dhe Siguria.

Raporti përcakton se sistemi gjyqësor i Shqipërisë është i përgatitur mesatarisht, dhe se Shqipëria ka vazhduar zbatimin e reformës gjithëpërfshirëse në drejtësi, duke rezultuar në një progres të mirë. Progresi ka vazhduar me emërimin e 6 gjyqtarëve në GJL, dhe me emërimin e 3 gjyqtarëve të rinj në GJK e cila rifitoi kuorumin e nevojshëm, prej minimumi 6 anëtarësh, për të mbajtur seancat plenare, duke qenë kështu plotësisht funksionale dhe duke përmbushur kushtin e vendosur nga KPN, i cili vazhdon të përmbushet. Sipas raportit, vlerësimi i përkohshëm i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve ka avancuar në mënyrë të qëndrueshme, duke vazhduar të japë rezultate të prekshme. Po ashtu SPAK dhe BKH, janë funksionale duke bërë disa përparime në forcimin e luftës kundër korrupsionit në Shqipëri. Më tej raporti i KE vlerëson se, zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit është gjithashtu në rrugën e duhur.

Duhet konsideruar i rëndësishëm ky raport vjetor i Komisionit, si një mundësi shumë e mirë për gjykatat, administratën publike, institucionet dhe organizatat e përfshira në këtë fushë, për të parë se në cilat fusha vendi ka bërë progres, dhe për të kuptuar më mirë fushat në të cilat reforma të mëtejshme janë të nevojshme.

## ***2.5 Asistenca Financiare e BE për Shqipërinë.***

### **➤ PHARE**

Shqipëria u bë përfituese e Programit PHARE në vitin 1992, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet BE dhe Shqipërisë. PHARE është projektuar për të ndihmuar vendet kandidatë në forcimin e kapacitetit të tyre institucional duke i bërë ata të aftë për të përmbushur sfidat e anëtarësimit në BE. Ky program fokus të veçantë kishte forcimin e kapaciteteve të administratës publike. Shuma totale e fondeve PHARE për Shqipërinë gjatë periudhës 1991-2000 arriti vlerën e 631.5 milion Euro.

### **➤ CARDS**

Programi CARDS u miratua në vitin 2000, në kuadër të Procesit të Stabilizim Asociimit. Ky program arriti vlerën e 4.6 miliardë eurove, ofruar për të ndihmuar vendet e rajonit të Ballkanit në katër fusha kryesore:

- rindërtim, stabilizim demokratik, bashkërendim dhe kthim të emigrantëve,
- zhvillim institucional dhe legjislativ, duke përfshirë harmonizimin me normat dhe ligjet e BE, për të përforcuar demokracinë dhe sundimin e ligjit,
- zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, duke përfshirë reformën strukturore,
- promovim të marrëdhënieve të ngushta dhe bashkëpunimit rajonal midis vendeve të Ballkani dhe BE.

## ➤ **IPA**

Që prej viti 2007, Bashkimi European paraqiti një instrument të ri në perspektivën financiare për periudhën 2007-2013 të quajtur IPA. IPA përbën një kuadër të vetëm legjislativ i cili ka zëvendësuar të gjitha instrumentet dhe programet e mëparshme të ndihmës së ofruar nga BE për mbështetjen e Ballkanit Perëndimor.

Ky instrument aplikohet për vendet kandidatë të Ballkanit Perëndimor. Që prej krijimit të saj, IPA u bë instrumenti kryesor që i mbështet këto vende gjatë përshtatjes së sistemit të tyre me standardet dhe politikat europiane.

**IPA I** është e përbërë nga disa komponentë :

- Asistenca e Tranzicionit dhe Ngritja e Institucioneve,
- Bashkëpunimi Rajonal dhe Ndërkufitar,
- Zhvillimit Rajonal,
- Zhvillimi i Burimeve Njerëzore,
- Zhvillimi Rural.

Vendet përfituese të IPA grupohen në dy kategori: vendet kandidatë potenciale për në BE, si Shqipëria, Bosnjë-Herzegovina, Serbia dhe Kosova, që përfitojnë pjesërisht nga IPA, aktualisht nga komponentët i parë dhe i dytë. Si dhe vendet kandidatë për BE si Kroacia, Turqia, Maqedonia dhe Mali i Zi, të cilët përfitojnë nga pesë komponentët e IPA.

**IPA II** mbështetet në rezultatet e arritura për periudhën 2014-2020. Përfituesit aktualë janë Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Islanda, Kosova, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia. Sektorët prioritarë për financim janë :

- Demokracia dhe qeverisja,
- Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore,
- Mjedisi, Transporti,
- Konkurrenca dhe inovacioni,
- Arsimi, punësimi dhe politikat sociale,
- Bujqësia dhe zhvillimi rural,
- Bashkëpunimi rajonal dhe territorial.

**IPA III** u miratua më 15 Shtator 2021 nga Parlamenti European. Ky instrument është vazhdimësi e IPA II dhe ndihmon në përgatitjen e partnerëve për anëtarësimet e ardhshme në Bashkimin European për periudhën 2021-2027. Përfituesit janë Shqipëria, Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Maqedonia e Veriut, Kosova, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia. Objektivat kryesore të IPA III janë :

- Promovimi i vlerave të përbashkëta,
- Reforma për modernizimin e shoqërisë dhe ekonomisë,
- Rimëkëmbja e shoqërisë pas COVID-19,
- Përafrimi me rregullat dhe standardet e BE,
- Stabilitet afatgjatë për të gjithë.

## ***2.6. Procesi Screening***

Negociatat për anëtarësim shënojnë momentin kyç në proceset integruese të një vendi për në BE. **Procesi i negociatave të anëtarësimit** të vendit kandidat **konsiston në tre faza:**

- **Në marrjen e statusit të vendit kandidat**– çka nuk nënkupton automatikisht hapjen e negociatave të anëtarësimit.
- **Në hapjen zyrtare të negociatave për anëtarësim**– proces ky që përfshin përthithjen e *acquis* në sistemin kombëtar juridik, përgatitjet për zbatimin e tij dhe zbatimin e reformave ligjore, politike, ekonomike, administrative e të tjera reformave të nevojshme që vendi të anëtarësohet në BE, ndryshe **kriteret për anëtarësim.**
- **Në përfundimin e negociatave** dhe reformave- vendi kandidat pas këtij momenti mund të **anëtarësohet në BE.**

Përbushja e kritereve për anëtarësim, pra harmonizimi me *acquis* të BE-së, konsiston në **tre aktivitete komplementare** me njëri-tjetrin:

- **Në përafrimin e legjislacionit vendas me *acquis* të BE-së;**

- Në **ngritjen e institucioneve** të nevojshme për zbatimin e legjislacionit në fjalë dhe në **rritjen e kapaciteteve administrative**;
- Në **vërtetimin përmes treguesve të qendrushëm të performancës** të zbatimit të legjislacionit të përafuar.

**Negociatat zhvillohen mes ministrave dhe ambasadorëve** të qeverive të vendeve anëtare dhe vendit kandidat përmes **Konferencës Ndërqeveritare**. Konferenca e parë Ndërqeveritare është më e rëndësishmja politikisht duke qenë se përcakton kuadrin e përgjithshëm për negociatat, si dhe hapjen zyrtare të tyre. Këtu **shkëmbehen qëndrimet e përgjithshme negociuese mes BE-së dhe vendit kandidat** dhe prezantohen grupet negociatore.

Për qëllime të procesit të negociatave, **acquis i BE-së ndahet në 35 kapituj negociues** (fusha politikash). Vendi kandidat nuk negocion mbi acquis e BE-së, por mbi transpozimin e zbatimit të tij.

*Procesi nis me vlerësimin analitik të përafritit të legjislacionit me acquis, ndryshe me procesin screening.* Screening organizohet në dy faza:

- Në **Takimet Shpjeguese** (Shumëpalëshe), ku Komisioni Evropian shpjegon acquis e BE-së për vendin kandidat; dhe
- Në **Takimet Dypalëshe**, ku është vendi kandidat ai që duhet të prezantojë nivelin e tij të përafritit me acquis dhe të shprehë gatishmërinë për përafritimin e tij tërësisht në të ardhmen.

Përgjithësisht procesi screening zgjat nga 1 deri në 2 vite. Më pas Komisioni harton **raportin screening** ku i paraqet vendeve anëtare gjetjet sa i takon nivelit të përgatitjes së vendit kandidat për anëtarësim për çdo kapitull negociues. Konkluzioni i këtij raporti është rekomandimi për të hapur drejtpërdrejt negociatat ose për të vendosur kriteret të caktuara për hapjen- **piketat për hapjen (opening benchmarks)**– të cilat duhen përmbushur.

Para se të nisnin negociatat për kapituj specifik, vendi kandidat duhet të depozitojë pozicionin e tij negociues, ndërsa BE miraton pozicionin e saj të përbashkët. Për shumicën e kapitujve **BE cakton piketa përfundimtare (closing benchmarks)**, të cilat duhen

përbushur nga vendi kandidat para se të mund të mbyllen negociatat në kapitullin respektiv.

Kohëzgjatja e negociatave varet nga shpejtësia e zbatimit të reformave dhe përafrimit të legjislacionit të BE-së (acquis) nga vendi kandidat. Pasi arrihet një marrëveshje mes BE-së dhe vendit kandidat, si dhe pasi të jenë përbushur piketat përfundimtare, kapitulli respektiv konsiderohet “**pjesërisht i mbyllur**”. Në çdo rast, negociatat nuk konsiderohen të mbyllura tërësisht për një kapitull, derisa çdo vend anëtar i BE-së të jetë plotësisht i kënaqur me progresin e vendit kandidat në kapitullin në fjalë. Procesi i negociatave përfundon vetëm pasi të jetë mbyllur çdo kapitull negociues, siç konfirmohet nga konkluzionet përkatëse të Këshillit Evropian.

Rezultatet e negociatave përfshihen në dispozitat e Traktatit të Anëtarësimit, i cili më pas nënshkruhet nga vendi kandidat dhe institucionet e BE-së dhe ratifikohet nga ky i fundit dhe çdo vend anëtar. Më pas, vendi kandidat bëhet anëtar i Bashkimit Evropian



## **Kapitulli III : Reforma në Drejtësi.**

### ***3.Reforma në Drejtësi.***

Reforma në Drejtësi është një iniciativë e Qeverisë dhe e Kuvendit të Shqipërisë me qëllim rritjen e pavarësisë dhe fuqizimin e sistemit të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit, për të qënë kandidatë të denjë në procesin e anëtarësimit në BE. Reforma në Drejtësi është një reformë që prek në tërësi çdo element të sistemit aktual të drejtësisë duke e përmirësuar atë.

Kjo reformë filloi me ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë. Komisioni i Posaçëm Parlamentar përgatiti një dokument analitik gjatë vitit 2015, i cili kishte si qëllim analizimin e gjendjes aktuale të sistemit të drejtësisë, duke evidentuar problematikat që prekin sistemin tonë të drejtësisë në të gjitha fushat e organizimit, funksionimit dhe administrimit të tij. Kto analiza do të shërbenin për hartimin e një strategjie dhe plani veprimi në funksion të identifikimit të problemeve në mënyrën më të efektshme të mundshme.

Në thelb të Reformës në Drejtësi ishte miratimi nga Kuvendi i ndryshimeve kushtetuese në 21 Korrik 2016, ku nga 26 nene të Kushtetutës që i përkasin sistemit të drejtësisë, Reforma ndryshoi 21 prej tyre, duke u shtuar 23 pika të reja. Pas miratimit të këtyre ndryshimeve kushtetuese u miratua e paketa me Ligjet Organike, si ligji për ri-vlerësimin e përkohshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.

Reforma e sistemit të drejtësisë në Shqipëri është reforma më gjithëpërfshirëse e kryer në vend në 30 vitet e fundit, dhe është një çështje me rëndësi të madhe për integrimin e vendit në BE. Arsyeja kryesore e ndërmarrjes së kësaj reforme ishte zgjidhja e çështjeve të ndryshme shqetësuese në lidhje me mosfunksionimin e gjyqësorit në Shqipëri, si korrupsioni, dhe mungesa e pavarësisë, profesionalizmit dhe transparencës së institucioneve gjyqësore. Vizioni kryesor i reformës ishte rikthimi i besimit të gjyqësori, përmes një procesi të thelluar ndryshimesh kushtetuese, ligjore dhe institucionale.

Bazuar në aktet kushtetuese të miratuara gjatë reformës në drejtësi në vitin 2016, është kryer një punë intensive legislative, duke përfshirë:

- Miratimin e 7 ligjeve themelore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjyqësorit, Prokurorisë dhe institucioneve të qeverisjes së drejtësisë,
- Ndryshimet e miratuara në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, dhe ligjin për gjykatat administrative,
- Miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

### ***3.1. Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë***

Reforma në sistemin e drejtësisë është e konceptuar mbi 7 shtylla bazë, që së bashku përbëjnë të plotë ndërtesën e sistemit të drejtësisë në vend. Konkretisht këto shtylla janë:

- I. *Sistemi i drejtësisë sipas Kushtetutës dhe Gjykata Kushtetuese* do të fokusohet në realizimin e objektivave të mëposhtëm specifikë:

**Objektivi 1** Ruajtja e ekuilibrave që rrjedhin nga roli i Presidentit të Republikës në sistemin e drejtësisë dhe garantimi i bashkëpunimit mes institucioneve kushtetuese.

**Objektivi 2.** Ridimensionimi nga pikëpamja kushtetuese i institucioneve që lidhen me gjyqësorin, si Gjykata e Lartë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm, me synimin kryesor garantimin e një gjyqësori të pavarur, të paanshëm, efektiv dhe llogaridhënës.

**Objektivi 3.** Garantimi i pavarësisë dhe i efektivitetit të Gjykatës Kushtetuese në këndvështrimin kushtetues

**Objektivi 4.** Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të Gjykatës Kushtetuese në nivel ligjor

- II. *Pushteti gjyqësor* - është guri i themelit për funksionimin e demokracisë dhe të shtetit ligjor, si dhe një garanci për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të individit. Reforma në gjyqësor do t'i adresojë të gjitha problemet e evidentuara përmes ndërhyrjeve të nevojshme kushtetuese dhe legislative të organizuara sipas objektivave të mëposhtëm kryesorë:

**Objektivi 1.** Rritja e aksesit dhe efektivitetit në sistemin gjyqësor nëpërmjet riorganizimit të gjykatave në përputhje me standardet evropiane.



**Objektivi 2.** Garantimi i pavarësisë dhe efektivitetit të Gjykatës së Lartë

**Objektivi 3.** Mirëqeverisja e gjyqësorit në funksion të pavarësisë, përgjegjshmërisë, eficiencës dhe transparencës së tij.

**Objektivi 4.** Konsolidimi i garancive të statusit të gjyqtarit, përgjegjësisë dhe llogaridhënies në ushtrimin e detyrës në përputhje me standardet evropiane

**Objektivi 5.** Garantimi i transparencës së pushtetit gjyqësor dhe të së drejtës për një proces të rregullt ligjor në përputhje me standardet evropiane.

**Objektivi 6.** Rritja e eficiencës së administratës gjyqësore në përputhje me standardet evropiane.

**Objektivi 7.** Krijimi i një raporti të ri të sistemit tonë gjyqësor me gjykatat evropiane.

**Objektivi 8.** Rritja e efektshmërisë së sistemit të drejtësisë nëpërmjet zbatimit të vendimeve gjyqësore dhe vendimeve të arbitrazhit në përputhje me standardet evropiane

*III. Drejtësia penale - Drejtësia penale është një ndër shtyllat kryesore të shtetit të së drejtës. Në ditët e sotme ajo përballë me format e reja të sofistikuar të kriminalitetit, që kërkojnë përmirësim të legjislacionit dhe rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së agjencive të specializuara në luftën kundër kriminalitetit. Reforma në drejtësinë penale do të përqendrohet në realizimin e këtyre objektivave kryesorë:*

**Objektivi 1.** Rritja e eficiencës dhe efektivitetit të drejtësisë penale nëpërmjet konsolidimit të misionit dhe funksioneve të prokurorisë, si dhe përmes riorganizimit të strukturave të saj dhe rishpërndarjes së përgjegjësive mes tyre.

**Objektivi 2.** Konsolidimi i garancive të statusit të prokurorit, përgjegjësisë dhe llogaridhënies në ushtrimin e detyrës.

**Objektivi 3.** Riorganizimi në tërësi i policisë gjyqësore, duke forcuar dhe përmirësuar statusin e saj, profesionalizmin, përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe eficiencën

**Objektivi 4.** Forcimi i garancive procedurale në fazën e hetimeve paraprake dhe gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në apel

**Objektivi 5.** Përmirësimi i Kodit Penal me qëllim harmonizimin e tij me standardet e BE-së.

**Objektivi 6.** Rritja e efektivitetit të sistemit të drejtësisë penale.

**Objektivi 7.** Forcimi dhe përmirësimi i statusit dhe pozitës juridike të viktimës në procesin penal

**Objektivi 8.** Reformimi i sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin duke forcuar sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive të drejtave të tyre procedural

*IV. Edukimi ligjor dhe arsimit juridik - Analiza e Sistemit të drejtësisë ka nxjerrë në pah një sërë problematikash dhe mangësish në lidhje me edukimin ligjor dhe arsimin juridik si një prej shtyllave kryesore në formimin e juristëve të ardhshëm dhe qytetarëve me njohuri solide mbi ligjin dhe të drejtën. Aktualisht arsimit juridik nuk është konkurrues në nivel evropian e më gjerë. Përvoja e pakët, debati dhe literatura e varfër juridike, mungesa e familjarizimit me të drejtën ndërkombëtare e evropiane, kapacitetet financiare të pamjaftueshme janë disa nga problemet më kryesore me të cilat përballlet sot arsimit juridik.*

Për shkak të rëndësisë primare që ka edukimi ligjor dhe arsimit juridik në mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë në tërësi, si dhe me qëllim reformimin e plotë dhe efektiv të sistemit të formimit juridik të profesionistëve të së drejtës dhe të pajisjes së qytetarëve me njohuritë e duhura juridike për respektimin e ligjit, në vijim janë përcaktuar disa objektiva strategjike :

**Objektivi 1.** Rritja e ndërgjegjësimit qytetar për rëndësinë e zbatimit të ligjit.

**Objektivi 2.** Reformimi i sistemit të arsimit juridik universitar.

**Objektivi 3.** Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe praktikave të trajnimit fillestar dhe vazhdues për profesionet ligjore.

**Objektivi 4.** Konsolidimi i sistemit të rekrutimit, trajnimit fillestar, trajnimit vazhdues dhe profilizimit të magjistratëve.

V. Shërbimet ligjore dhe profesionet e lira - Shërbimet ligjore - Avokatia, Noteria, Përmbartimi gjyqësor, Ndërmjetësimi dhe Avokatura Shtetit - janë pjesë e rëndësishme e funksionimit të sistemit të drejtësisë në Republikën e Shqipërisë. Në kushtet e sotme reformimi i sistemit të drejtësisë dikton nevojën edhe të reformimit e të përmirësimit të këtyre shërbimeve, duke u nisur edhe nga vetë problematikat e evidentuara nga Analiza e Sistemit të Drejtësisë.

**Objektivi 1.** Përmirësimi i nivelit të shërbimeve të avokatisë dhe rritja e profesionalizmit, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies në ushtrimin e këtij profesioni.

**Objektivi 2.** Përmirësimi i nivelit të shërbimeve të noterisë dhe rritja e profesionalizmit, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies në ushtrimin e këtij profesioni

**Objektivi 3.** Garantimi i ekzekutimit efektiv të titujve ekzekutiv duke përmirësuar rregullat procedurale dhe nivelin e shërbimit të përmbartuesve, si dhe duke rritur profesionalizmin, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien në ushtrimin e këtij profesioni

**Objektivi 4.** Rritja e përdorimit të dhe nivelit të shërbimit të ndërmjetësimit si dhe profesionalizmit, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së ndërmjetësve

**Objektivi 5.** Fuqizimi i rolit të Avokaturës së Shtetit për përfaqësimin e interesave pasurorë të shtetit

VI. Masat në luftën kundër korrupsionit - Kjo shtyllë e strategjisë për reformimin e drejtësisë synon të trajtojë e japë zgjidhje për një nga fenomenet më negative që karakterizon sistemin e drejtësisë në vend, korrupsionin. Prandaj, qëllimi kryesor i reformës nën këtë shtyllë ndër të tjera është dhe ngritja e një sistemi vetëpastrimi të radhëve të sistemit të drejtësisë e veçanërisht të gjyqësorit dhe prokurorisë nga elementët e korruptuar, përmes një kontrolli efektiv të aftësive të tyre profesionale dhe integritetit të tyre moral dhe etik. Vetëm kështu institucionet e sistemit të drejtësisë do të mund të çlirojnë potencialin e tyre në luftën kundër korrupsionit në shoqëri e veçanërisht në radhët e zyrtarëve të lartë. Nisur nga gjetjet dhe problemet e evidentuara në Analizën e Sistemit të

Drejtësisë objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet masave konkrete për të luftuar korrupsionin janë:

**Objektivi 1.** Nxitja e pjesëmarrjes së publikut në luftën kundër korrupsionit

**Objektivi 2.** Krijimi i një trupe gjyqtarësh dhe prokurorësh me integritet të lartë etiko-moral dhe profesional, duke përmirësuar sistemin e vlerësimit dhe rivlerësimit të performancës dhe etikës së tyre.

**Objektivi 3.** Parandalimi i korrupsionit nëpërmjet rritjes së përgjegjshmërisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe forcimit të hetimit administrativ dhe penal mbi pasuritë e tyre.

**Objektivi 4.** Ndëshkueshmëria e veprave penale në fushën e korrupsionit duke synuar forcimin e zbulimit dhe hetimit proaktiv dhe krijimin e strukturave të specializuara antikorrupsion

**Objektivi 5.** Ndalimi i korrupsionit me anë të plotësimit të kuadrit ligjor dhe konsolidimit të politikës penale në këtë fushë

*VII. Financimi dhe mbështetja infrastrukturore e sistemit - Nuk mund të ketë pavarësi të pushtetit gjyqësor pa pavarësinë financiare të tij. Asnjë reformë strategjike në sistemin e drejtësisë nuk mund të realizohet dhe të ketë sukses pa një financim të përshtatshëm, sipas prioriteteve të identifikueshme nëpërmjet reformave.*

**Objektivi :** Mbështetje e nevojshme financiare dhe infrastrukturore të sistemit të drejtësisë, duke synuar në rritjen e pavarësisë, eficiencës dhe profesionalizmit të tij.

Këto 7 shtylla janë edhe pjesët kryesore përbërëse të Analizës së Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri. Dokumenti Strategjik do t'i nënshtrohet një procesi transparent konsultimesh me qytetarë të angazhuar, me aktorët e vetë sistemit, grupet e interesit dhe shoqërinë civile, duke pasur gjithnjë në fokus synimin e përgjithshëm për krijimin e një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimit, të hapur, të përgjegjshëm dhe eficient, i cili të gëzojë besimin e publikut, të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit dhe të mundësojë integrimin e tij në familjen evropiane.

### **3.2 Institucionet e Drejtësisë.**

Si pasojë e ndryshimeve të Reformës në Drejtësi, është parashikuar ngritja e një numër institucionesh të reja, si dhe ndryshime të institucioneve ekzistuese :

- ***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi***

KED është institucion i ri, i cili do të ushtrojë rolin kryesor në emërimet në sistemin e drejtësisë. Përgjegjësitë kryesore të tij janë vlerësimi i përmbushjes së kushteve e kriterëve ligjore, profesionale dhe morale nga kandidatët për emërim si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. KED përbëhet nga 9 anëtarë që zgjidhen çdo vit me short me mandat 1 vjeçar, në këtë formë: 2 anëtarë nga gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, 1 anëtar nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, 1 anëtar prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, 2 anëtarë nga gjyqtarët, 2 anëtarë nga gjykatat e apelit, dhe 1 anëtar nga gjykatat administrative.

- ***Gjykata Kushtetuese***

Përpara ndryshimeve kushtetuese, anëtarët e GjK zgjidheshin me propozim të Presidentit dhe miratoheshin me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi. Pas Reformës, anëtarët e GJK do të zgjidhen : 3 anëtarë nga Gjykata e Lartë, 3 anëtarë nga Presidenti, dhe 3 anëtarë nga Kuvendi me 3/5 të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

- ***Këshilli i Lartë i Gjyqësorit***

Përpara ndryshimeve kushtetuese qeverisja e sistemit të drejtësisë ishte përgjegjësi e KLD. Në vend të tij, ndryshimet kushtetuese parashikojnë ngritjen e KLGj, i cili do të jetë përgjegjës për sigurimin e pavarësisë, mbarëvajtjes dhe llogaridhënies në sistemin gjyqësor. KLGJ emëron gjyqtarët e të gjitha niveleve, me përjashtim të atyre të Gjykatës Kushtetuese, dhe vendos për masat disiplinore dhe shkarkimin e gjyqtarëve. KLGJ përbëhet nga 6 gjyqtarë të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, dhe 5 anëtarë të zgjedhur nga rradhët e avokatëve, akademikëve dhe shoqërisë civile.

- ***Këshilli i Lartë i Prokurorisë***

KLP është një institucion i ri i krijuar për herë të parë, i cili është përgjegjës për sigurimin e pavarësisë, mbarëvajtjes dhe llogaridhënies në sistemin e prokurorisë.

- ***Gjykata e Lartë***

Përpara ndryshimeve kushtetuese, zgjedhja e anëtarëve të GjL bëhej me propozim të Presidentit dhe miratim me shumicë të thjeshtë votash nga Kuvendi. Si pasojë e Reformës, zgjedhja e anëtarëve të GjL bëhet nga KLGJ. Ajo kujdeset për unifikimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore.

- ***Prokurori i Përgjithshëm***

Përpara ndryshimeve kushtetuese PP emërohej me mandat 5 vjeçar me të drejtë riemërimi. me ndryshimet që solli Reforma, Prokurori i Përgjithshëm emërohet me mandat 7 vjeçar pa të drejtë riemërimi. Zgjedhja e PP bëhet nga KLP, i cili për zgjedh tre kandidaturat më të mira dhe ja përcjell Kuvendit për miratim. Në rast se Kuvendi brenda 30 ditëve nuk arrin të sigurojë shumicë me 3/5 të të gjithë anëtarëve të vet, atëherë konsiderohet i emëruar kandidati i renditur më lart nga KLP.

- ***Gjykatat e posaçme të korrupsionit dhe krimit të organizuar***

Reforma parashikoi krijimin e dy gjykatave të posaçme, Gjykata e posaçme e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe të akuzave penale kundër funksionarëve të lartë, si: Presidentin dhe ish-presidentët, Kryetarin dhe ish-Kryetarët e Kuvendit, Kryeministrin dhe ish-Kryeministrat, deputetët e Kuvendit, ministrat, Prokurorin e Përgjithshëm, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, kryetarët e bashkive, zëvendësministrat, anëtarët e KLGJ dhe të KLP, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, dhe drejtuesit e institucioneve shtetërore qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj. Këto gjykata do të pushojnë së ekzistuari pasi funksionet e tyre do të merren nga gjykatat e posaçme.

- ***Prokuroria e Posaçme***

Reforma parashikoi krijimin e dy institucioneve të reja të hetimit dhe prokurorisë, Prokurorinë e Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH), të cilat janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Prokuroria e Posaçme ushtron funksionet pranë gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe BKH raporton vetëm tek ajo. Prokurorët e prokurorisë së posaçme emërohen nga KLP për një mandat 9 vjeçar.

- ***Inspektori i Lartë i Drejtësisë***

ILD është një institucion i ri, përgjegjës për verifikimin e ankesave kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të KLGJ, anëtarëve të KLP, dhe të Prokurorit të Përgjithshëm. ILD është përgjegjës gjithashtu, për inspektimin institucional të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë. Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet për një periudhë 9 vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, dhe emërohet nga Kuvendi.

### **3.3 Arritjet e Realizuara nga Reforma në Drejtësi dhe Paketa e Ligjeve në Reformën në Drejtësi**

#### **➤ 3.3.1. Arritjet e Realizuara nga Reforma në Drejtësi**

Reforma që po zbatohet në sistemin e drejtësisë ka si qëllim harmonizimin e sistemit gjyqësor shqiptar me standardet e BE në lidhje me pavarësinë, paanshmërinë, llogaridhënien, cilësinë e drejtësisë dhe efikasitetin e këtij sistemi. Në këtë kuadër arritjet kryesore që ka sjellë kjo reformë janë :

- institucionet e reja të reformës në drejtësi si KLGJ, KLP, KED, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), ILD, dhe Gjykata Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, janë tërësisht funksionale,
- ka pasur përparësi procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve,
- Kolegji i Posaçëm i Apelit ushtron funksionin e tij në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pas paraqitjes së ankimit nga subjektet e rivlerësimit,
- emërimi i drejtuesit të BKH dhe nisjes së procesit për emërimin e 60 hetueseve,
- emërimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë,
- për vitin 2020 janë marrë afërsisht 180 vendime nga Kolegjet e GJK,
- KLP ka miratuar Rregulloren për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorëve;

- KLP ka marrë një sërë vendimesh lidhur me emërimin e përkohshëm të prokurorëve,
- përveç kryerjes së procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ILDKPKI ka administruar deklaratat e pasurisë së subjektit kandidat për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë,
- ngritja e një sistemi tërësisht funksional nga Ministria e Drejtësisë për garantimin e ndihmës juridike falas parësore dhe dytësore.

### ➤ ***3.3.2. Paketa e Ligjeve në Reformën në Drejtësi***

Vendi ynë ndërmori një reformë të gjithanshme në drejtësi. Pas ndryshimeve kushtetuese, ndryshime të cilat hynë në fuqi në 11 gusht 2016, u miratuan 7 ligje që implementojnë reformën kushtetuese.

- Ligj nr. 84/2016 datë 06.10.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Ligj nr. 95/2016 datë 06.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”
- Ligj nr. 96/2016 datë 06.10.2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Ligj nr. 97/2016 datë 06.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”
- Ligj nr. 98/2016 datë 06.10.2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”
- Ligj nr. 115/2016 datë 03.11.2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”
- Ligj nr. 8577 datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”



### **3.4 Vetingu.**

Një nga risitë më të mëdha të Reformës në Drejtësi është Procesi i Rivlerësimit Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve-Vetingu, i cili ka për qëllim që të garantojë dhe sigurojë profesionalizmin dhe integritetin e punonjësve të sistemit të drejtësisë, në mënyrë për të garantuar një drejtësi të pavarur dhe të ndershme duke synuar largimin nga sistemi e të gjithë magjistratëve që nuk justifikojnë pasurinë, që kanë lidhje me krimin ose që nuk kanë aftësitë e duhura profesionale. Përgjatë procesit të vetingut, vlerësohen të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, si dhe inspektorët e KLD.

Rivlerësimi filloi në Tetor 2016, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese dhe të ligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Rivlerësimi i të gjithë subjekteve duhet të kryhet brenda një periudhe 5-vjeçare. Procesi i vetingut realizohet nga tre institucione të posaçme të krijuara nga Kushtetuta për këtë qëllim. Këto institucione bashkërendojnë dhe asistohen nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, një mision i posaçëm i BE, i përbërë nga vëzhgues me eksperiencë nga vendet anëtare të BE dhe nga SHBA.

Këto institucione janë :

#### **1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit**

KPK funksionon si organ administrativ vlerësues dhe do përbëhet nga 4 trupa komisionerësh, të përbëra secila nga 4 komisionerë. Anëtarët e Komisionit gëzojnë statusin e anëtarit të Gjykatës së Lartë.

#### **2. Komisionerët Publikë**

Përfaqësojnë interesin publik në procesin e vetingut dhe kanë të drejtën të ankimojnë vendimet e KPK në Kolegjin të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese.

#### **3. Kolegji i Posaçëm i Apelit**

KPA është institucioni përfundimtar që shqyrton ankimet kundër vendimeve të KPK. Ai përbëhet nga 7 gjyqtarë, por gjykon në trupa gjyquese me 5 anëtarë. Anëtarët e Kolegjit gëzojnë statusin e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

#### ***4. Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit***

ONM asiston procesin e vetingut nëpërmjet mbikqyrjes së procesit dhe ndihmës për KPK dhe KPA përmes ofrimit të të dhënave, informacioneve dhe këshillimit. Vëzhguesit e ONM monitorojnë gjithë procesin e vetingut dhe kanë në dispozicion të gjithë informacionin dhe dokumentet që disponon KPK dhe KPA.

– Procesi i Vetëingut bazohet mbi 3 shtylla rivlerësimi :

- **Kontrolli i pasurisë**

Cdo subjekt i procedurës së vetingut i nënshtrohet vetëdeklarimit dhe më pas kontrollit të të gjitha pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të. Subjekti duhet të justifikojë pasurinë e tij mbi bazën e burimeve të ligjshme, të cilat konsiderohen vetëm të ardhura të deklaruara, për të cilat janë paguar taksat. Nëse pasuria e deklaruar apo zbuluar është më e madhe se dyfishi i të ardhurave të ligjshme, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës dhe përjashtohet nga sistemi nëse nuk arrin të vërtetojë të kundërtën.

- **Kontrolli i figurës**

Subjekti i rivlerësimit i nënshtrohet verifikimit të kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nëse verifikohen kontakte të tilla dhe subjekti nuk arrin të vërtetojë të kundërtën, ai shkarkohet nga sistemi i drejtësisë.

- **Kontrolli i aftësive profesionale**

Subjekti i rivlerësimit i nënshtrohet verifikimit të aftësive për të hetuar dhe gjykuar çështjet gjyqësore, aftësitë organizative dhe administrative si dhe etikën profesionale dhe cilësitë personale. Subjekti që vlerësohet se ka mangësi, të cilat nuk mund të korrigjohen përmes edukimit, shkarkohet menjëherë. Subjekti që vlerësohet se ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të papërshtatshme por që mund të përmirësohen, pezullohet dhe i nënshtrohet një programi trajnimi të detyrueshëm 1-vjeçar.

#### ***3.5 Lufta Kundër Korrupsionit.***

Lufta kundër korrupsionit vazhdon të jetë ndër fokuset kryesore të Qeverisë Shqiptare, të cilit i është kushtuar një vëmendje e madhe në aspektin ligjor, me qëllim zbatimin në mënyrë ndërkombëtare për të pasur rezultate të efektshme. Reformat kundër korrupsionit janë orientuar në parandalimin, hetimin dhe ndëshkimin e akteve të korrupsionit.

Një ndër arritjet kryesore të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit është zbatimi i reformës në drejtësi dhe ngritja e institucioneve të posaçme për luftën kundër korrupsionit. Përveç ndikimit që ka sjellë procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, një arritje për tu vlerësuar është edhe ngritja e Byrosë Kombëtare të Hetimit, BKH, dhe Prokurorisë së Posaçme SPAK, e cila ka filluar të ushtrojë funksionet e saj prej datës 19 Dhjetor 2019.

Ngritja e këtyre institucioneve ka filluar të japë edhe rezultatet e para, ku SPAK ka regjistruar disa raste suksesi sic janë :

- 1) nisja e hetimeve nga SPAK kundër subjekteve me funksionin e ish-gjyqtarëve në GJL dhe GJK, për veprën penale të refuzimit të deklarimit të pasurisë së tyre,
- 2) fillimi i një procedim penal kundër komisionerëve të komisioneve të zgjedhjeve, të cilët janë akuzuar se kanë lejuar qëllimisht persona të ndryshëm të votojnë në emër të votuesve që ishin jashtë vendit në zgjedhjet e qershorit 2017,
- 3) fillimi i procedimeve penale kundër ish-magjistratëve mbi mosdeklarimet e pasurive,
- 4) miratimi i Planit të Veprimit 2020–2023 për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit,
- 5) ngritja dhe funksionimi i Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion,
- 6) me ligjin nr.19/2020 janë miratuar ndryshimet në ligjin nr.34/2019, “Për administrimin e pasurive të konfiskuara”,
- 7) marrja e masave në drejtim të ofrimit të shërbimeve online. Aktualisht ofrohen 759 shërbime online, duke përfshirë dhe shërbimet në sektorët më të ndjeshëm. Në total ka mbi 1.2 milionë përdorues të platformës e-Albania, të cilët mund të përdorin shërbimet elektronike, duke reduktuar nevojën e pranisë fizike në sportele.

### ***3.6 Parandalimi i Korrupsionit.***

Korrupsioni është një çështje shumë komplekse dhe e ndërthurur, për të cilën mund të merren masa të ndryshme. Qeveria Shqipëtare mund të arrijë në parandalimin e korrupsionit dhe rritjen e besimit të publikut nëpërmjet :

- rritjes së transparencës së qeverisjes, përmes përmirësimit të legjislacionit, procedurave dhe rritjes së kapaciteteve të institucioneve shtetërore,

- demonstrimit të një historie hetimesh, procedimesh të suksesshme dhe dënimesh të formës së prerë të rasteve të korrupsionit,
- rishikimit të rregullt dhe përshtatjeve të nevojshme të masave kundër korrupsionit, me qëllim rritjen e efikasitetit, duke përfshirë ndryshimet e nevojshme legislative, dhe një numër institucionesh të afta për parandalimin e korrupsionit,
- përmirësimin të komunikimit dhe konsultimeve me publikun e gjerë në procesin e hartimit dhe miratimit të akteve ligjore,
- miratimit dhe zbatimit të kornizës ligjore për të mbrojtur informatorët, si dhe krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës për mbrojtjen e tyre,
- uljes së shkallës së rasteve të korrupsionit me anë të gjurmimit, përgatitjes dhe nxjerrjes së statistikave të konsoliduara për rastet e korrupsionit,
- forcimit të sistemit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive të zyrtarëve publikë, nëpërmjet një sistemi online të deklarimit për të gjitha subjektet raportuese.

### ***3.7. Monitorimi i Reformës në Drejtësi***

Arsimi juridik dhe edukimi ligjor i publikut përbën një nga komponentët më të rëndësishëm në funksionimin e një sistemi gjyqësor të bazuar në profesionalizëm, paanësi dhe efikasitet. Një reformë tërësore dhe gjithëpërfshirëse në sistemin e drejtësisë nuk do të ishte e plotë, nëse nuk do të parashikonte ndërhyrje si në sistemin e formimit të profesionistëve të së drejtës, ashtu edhe në edukimin e publikut të gjerë me njohuri mbi ligjin. Prandaj, ishte e nevojshme që krahas reformimit të sistemit të funksionimit të gjyqësorit, prokurorisë dhe institucioneve që qeverisin sistemin e drejtësisë, të parashikohen edhe ndryshime në mënyrën e funksionimit të institucioneve të arsimit juridik, si dhe ato për edukimin e gjerë të publikut me njohuri mbi ligjin, me qëllim përmirësimin e standardeve të sistemit të drejtësisë dhe rritjen e aksesit të qytetarëve në drejtësi

Për realizimin e monitorimit në këtë seksion, janë përdorur një seri metodash të kombinuara të natyrës cilësore. Përmes desk research është synuar të evidentohen ndryshimet e kryera në kuadrin ligjor, strategjik dhe institucional, me qëllim zbatimin e objektivave të “Strategjisë së Reformës në Drejtësi” dhe “Planit të Veprimit”, në lidhje me edukimin ligjor dhe arsimin juridik.

## ***KONKLuzionet***

Që prej viteve '90, Shqipëria ka bërë një rrugëtim shumë të gjatë për të hapur negociatat për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Shteti ynë është përpjekur të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që të plotësojë kushtet e vendosura nga BE për integrim. BE vlerëson si shumë të rëndësishme përcaktimin e fushave të ndyshme politike, ekonomike e monetare të shteteve anëtare dhe atyre candidate, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore.

Kushtet themelore që BE i ka vendosur Shqipërisë për anëtarësim janë kriteret e Kopenhagenit, të cilat kanë të bëjnë me stabilitetin politik të institucioneve shtetërore, aftësinë ekonomike për të qëndruar në tregun europian, dhe përshtatjen e legjislacionit të brendshëm me traktatet, ligjet, dhe normat themelore të BE.

Në marrëdhëniet mes BE dhe Shqipërisë çështjet e drejtësisë janë prioritare për BE. Në kuadër të kësaj, kërkesat për përmirësimin e instrumentave të së drejtës kanë qenë të vazhdueshme. Ndër pikat më kryesore janë:

- rritja e transparencës në proceset gjyqësore,
- pavarësia e gjyqtarëve dhe mbrojtja e të drejtave të tyre,
- përmirësimi I statusit të administratës gjyqësore,
- rritja e bashkëpunimit ndërmjet organeve të drejtësisë,
- trajtimet e vazhdueshme të gjyqësorit,
- zbatimi i vendimeve gjyqësore.

Shqipëria është duke përmirësuar sistemin e drejtësisë, pavarësisht se ka hasur shumë vështirësi për shkak të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Në këtë aspekt është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi mes BE dhe Shqipërisë, nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme dhe ndihmesës në përmirësimin e legjislacionit, dhe zgjidhjes së problemeve që mund të dalin gjatë këtij procesi.

Përpjekjet e Shqipërisë për të qënë candidate e denjë për anëtarësim janë të shumta, ashtu si Reforma në Drejtësi e cila synon të prekë dhe përmirësojë cdo element të sistemit të drejtësisë, duke evidentuar të gjitha problemet që e cënojnë këtë sistem. Kjo do të bëhet e mundur nëpërmjet krijimit të institucioneve të reja të drejtësisë dhe ndryshimit të disa prej institucioneve të mëparshme.

Risi tjetër që ka sjellë kjo reformë është Procesi i Vetingut i cili ka për qëllim të garantojë profesionalizmin e cdo punonjësi të këtij sistemi, duke siguruar drejtësi dhe pavarësi, në mënyrë që të arrijmë standartet e integritetit në BE. Pavarësisht problemeve të shumta dhe ekonomisë jo shumë të favorshme, Shqipëria vazhdon të insistojë në integrimin europian, nëpërmjet ndryshimeve të vazhdueshme në legjislacionin dhe në krijimin e institucioneve anti-korrupsion, për të pasur një shtet të qëndrueshëm të së drejtës.

Hapja e negociatave të Shqipërisë me BE më 19 Korrik 2022, është një arritje e madhe për shqipëtarët. Ky vendim i BE vjen pas firmosjes së Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit mes Shqipërisë dhe BE në vitin 2006, pas pranimit nga BE të kërkesës së Shqipërisë për vend anëtar në vitin 2009, pas akordimit të heqjes së vizave për Shqipërinë në vitin 2010 dhe pas dhënies së statusit të vendit kandidat nga Komisioni Europian në vitin 2012.

Ky proces është një hap madhor për Shqipërinë, i bazuar në arritjet e përmendura më sipër. Hapja e negociatave do të thotë një proces teknik që do të nisë me kontrollimin e plotë të administratës shtetërore shqipëtare dhe të gjithë legjislacionit shqipëtar, që të përafrohet në mënyrë sa më të mirë me legjislacionin e Bashkimit Europian. Sa më shpejt të ecë Shqipëria në rrugën drejt BE, aq më shpejt do të lëvizin edhe institucionet europiane për anëtarësimin e saj me të drejta të plota. Tashmë sapo ka nisur puna për ëndrrën e madhe europiane !

## ***REKOMANDIMET***

- Shqipëria duhet të plotësojë funksionimin normal të Parlamentit, në bazë të dialogut politik që përfshin të gjitha partitë politike.
- Të miratojë ligje që vazhdojnë të qëndrojnë të pa miratuara.
- Të marrë masa për përafrimin sa më të madh të legjislacionit të saj aktual dhe të ligjeve që planifikohen të miratohen në vazhdim, me ligjet e BE.
- Të sigurojë mbajtjen e zgjedhjeve në përputhje me standartet ndërkombëtare europiane.
- Të ndërmarrë hapa konkretë në përmbushjen e reformës në drejtësi.
- Të forcojë zbatimin e ligjit në cdo fushë të shoqërisë.
- Të zbatojë në mënyrë efektive strategjitë e qeverisë për luftën kundër korrupsionit.
- Të zvogëlojë pengesat e investigimit, të cilat lidhen me hetimin e gjyqtarëve, prokurorëve, ministrave dhe deputetëve.
- Të forcojë luftën kundër krimit të organizuar.
- Të miratojë një strategji kombëtare për të drejtat e pronësisë, që duhet të parashikojë kthimin dhe kompensimin e pronave.
- Të marrë masa për përmirësimin e trajtimit të të ndaluarve në komisariate dhe paraburgim.
- Të përforcojë bashkëpunimin rajonal.
- Të realizojë funksionimin e plotë dhe profesional të institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe standartet europiane, duke garantuar pavarësi, efikasitet dhe llogaridhënie.



- Të forcojë transparencën dhe efikasitetin e gjyqësorit, në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe standardet europiane.
- Të krijojë një sistem që garanton respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe barazinë gjinore brenda shoqërisë.
- Të plotësojë vakancat në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën e Lartë.

## ***REFERENCAT***

- Adam Lazowski, Aida Gugu Bushati, *Bazat e së Drejtës Europiane*, Tiranë, 2014
- Erjona Canaj, Sokol Bana, *E Drejta e Bashkimit European*, Tiranë, 2011
- European Movement Albania, *Procesi i Anëtarësimit të Shqipërisë në BE*, 2022, [Online]
- Instituti i Studimeve Politike, *Reforma në Drejtësi, Aktualiteti dhe Problematika*, Tiranë 2018
- Konrad Adenauer Stiftung, *Reforma në Drejtësi*, 2018, [Online]
- Manuali i EURALIUS, *mbi Misionin e Asistencës Europiane për Shqipërinë*
- Marrëveshja e Përkohshme mes BE dhe Shqipërisë, *mbi Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar*, 1992
- Marrëveshja e Stabilizim Asocimit ndërmjet Komunitetit European e Shteteve Anëtare, dhe Shqipërisë, 11 Qershor 2006
- Ministria e Integritimit, *Shqipëria dhe Bashkimi European*, Tiranë 2007
- Raporti i Komisionit European, *mbi progresin e Shqipërisë gjatë rrugëtimit për integrimin në BE*, Strasburg, 19.10.2021.
- Vendim i Këshillit të Ministrave, *mbi Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për vitet 2015-2020*, Maj 2016
- Vendim i Këshillit të Ministrave, nr.90/2021, *mbi Miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin European për vitet 2021-2023*

- Vendim i Kuvendit, *nr.84/2016, për Rivlerësimin Kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*
- Vendim i Kuvendit, *nr.95/2016, për Organizimin dhe Funksonimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar*
- Vendim i Kuvendit, *nr.115/2016, për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri .*